



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.17.6-2014-08**

**RAPORT I AUDITIMIT**  
**PËR PROJEKTIN RREGULLIMI I KORIDOREVE TË GJELBËRTA**  
**NË KOMUNËN E FERIZAJIT**

*Auditimi sipas Marrëveshjes me UN Habitat No. 09/2013*

**Prishtinë, Shtator 2015**

## 1 Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), sipas marrëveshjes Nr. 09/2013 të datës 10 dhjetor 2013 me UN Habitat, ka kryer auditimin final të raportit financiar për projektin “Rregullimi i korridoreve të gjelbërta në Komunën e Ferizajt”. Ky projekt është pjesë e programit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal.

Komuna e Ferizajt dhe UN Habitat kishin lidhur marrëveshje me datën 01.07.2013 për bashkëfinancimin e këtij projekti me pjesëmarrje, UN-Habitat 46% dhe Komuna 54%.

## 2 Fushëveprimi

Është përgjegjësi e palëve të përgatisin raportin financiar. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është kontraktuar që të kryejë auditimin e raportit final financiar si dhe ekzaminimin fizik nëse punët janë kryer sipas marrëveshjes.

## 3 Realizimi i projektit

### Përshkrimi

Procedurat e prokurimit për realizimin e këtij projekti ishin zhvilluar nga Komuna. Derisa UN-Habitat kishte angazhuar një specialist të prokurimit për të ndihmuar në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Tenderi ishte zhvilluar me procedurë të hapur dhe kriter për dhënien e kontratës ishte çmimi më i ulët. Me datën 09.01.2014 komuna kishte lidhë kontratë me operatorin ekonomik “IDEALI”. Vlera e kontratës ishte 272,900€. Plani dinamik për realizimin e projektit ishte 70 ditë pune. Gjatë ekzekutimit të kontratës projekti kishte pësuar ndryshime. Vlera e realizuar e projektit pas ndryshimit ishte 243,932€ të miratuara edhe nga UN HABITAT.

Menaxheri i projektit ishte caktuar një inxhinier i ndërtimtarisë i komunës ndërsa si mbikëqyrës të punimeve në terren ishte kontraktuar kompaninë “Arch & Design”. Punimet kishin filluar më 03.03.2014 dhe kishin përfunduar më 28.04.2015.

Pas përfundimit të punëve, komuna kishte formuar komisionin për pranimin përfundimtar të punëve. Ky komision kishte bërë pranimin e punëve të projektit me 26.06.2015. Komisioni për pranimin teknik të punimeve ka vlerësuar se projekti ka përfunduar dhe punët ishin realizuar, por duke i identifikuar disa ndryshime nga projekti.

Sfidë e këtij projekti ka qenë respektimi i planit dinamik të përfundimit të punëve me kohë dhe ndryshimi substancial i tij gjatë realizimit në krahasim me paramasën dhe parallogarinë.

Ne analizuam nëse projekti është realizuar sipas marrëveshjes në mes të UN-Habitat, Komunës dhe Kompanisë 'IDEALI'.

### **Të gjeturat**

Ne kemi vërejtur se projekti gjatë ekzekutimit të tij ishte ndryshuar po thuhet në të gjitha pozicionet e kontraktuara. Më poshtë po i paraqesim disa nga ndryshimet:

- Pozicioni C1: Furnizimi dhe shtrirja e asfaltit pas objektit të sallës së sportit në vlerë 8,232€, sipas raportit të organit mbikëqyrës ishte përfunduar dhe pagesa ishte bërë. Në fakt, sasia e asfaltit të paraparë në këtë pjesë është përdorur në pjesën e fushës së sportit e cila gjendet para objektit të sportit. Sipas menaxherit të projektit, pozicioni C1 nuk është kryer përderisa sasia e asfaltit është vendosur në pozicionin C2;
- Pozicioni E2: Furnizimi dhe montimi i gjeotekstit në vlerë 1,102€ është zëvendësuar me beton të varfër. Ky pozicion, sipas raportit të organit mbikëqyrës ishte paguar për gjeotekstil;
- Pozicioni O1 dhe O2: Furnizimi i gypit të ujit në shiritin e gjelbërimit për ujitje dhe rregullimi i pusetës në vlerën 3,200€, është paguar si i përfunduar në situacionin e dytë, përderisa ajo nuk është përfunduar fare; dhe
- Pozicioni P1-P3: Punët nëntokësore për rregullimin e ndriçimit kanë ndryshuar për shkak se në projekt sasia e materialit elektrik nuk ishte paraparë si duhet.

Për shkak të ndryshimeve të punëve kundrejt specifikimeve të kontratës, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri nëse punimet e kryera në projekt janë ekuivalente me kundërvlerën e parasë së shpenzuar. Përveç kësaj, ne kemi vërejtur se:

- Ka pasur vonesa të paarsyeshme në realizimin e këtij projekti. Arsyeja e vonesave ishte angazhimi jo serioz i punë kryesit në përfundimin e punëve; dhe
- TVSH-ja ishte llogaritur në pagesat e bëra nga UN-HABITAT për shumën 33,165€.

Deri në kohën e auditimit, komuna i kishte paguar pjesën e vet operatorit 145,630€. UN-Habitat i kishte transferuar 81,646€ në llogarinë e komunës ndërsa komuna ia kishte transferuar 33,165€ operatorit ekonomik me datën 18.04.2014 duke paguar situacionin e parë pa e zbritur TVSH-në.

Gjendja e pagesave dhe obligimeve sipas kontratës është paraqitur në tabelën në vijim (€)

Bashkë financuesit	Obligimi i pagesës pas ndryshimit të kontratës (në €)	Paratë e transferuara nga UN Habitat në llogari të Komunës	Të paguara nga komuna në llogari të operatorit ekonomik	Borxhi i mbetur për pagesë
KK Ferizaj	131,455		145,630	(14,175)
UN-Habitat	112,477 <sup>1</sup>	81,646	33,165	15,316 <sup>2</sup>
Gjithsej:	243,932		178,795	

## 4 Konkluzione

Konkluzioni ynë është se cilësia punëve të kryera nuk ishte në përputhje të plotë me marrëveshjen për arsye të planifikimit të dobët të projektit. Ndryshimi i projektit, punët jo kualitative dhe vonesat duhet të analizohen nga partnerët e projektit dhe duhet të gjejnë mekanizma për të siguruar se kërkesat e marrëveshjes janë arritur, para se pagesat të jenë kryer.

### Rekomandime

#### Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Së bashku më gjithë akterët e involvuar në këtë projekt të diskutojnë realizimin e tij siç është, paraparë dhe t'i eliminoj të gjitha mangësitë e identifikuara; dhe
- Të kërkoj nga operatori ekonomik që të korrigjoj faturën nr. 01/2014 me vlerë 33,165€, e cila është dashur të faturohet pa TVSH.

#### Rekomandojmë UN-Habitat që të siguroj:

- Të mos paguaj shumën e mbetur prej 15,316€, pa u siguruar se janë eliminuar të gjitha mangësitë e projektit; dhe
- T'i lëshojë kompanisë "Ideali" konfirmimin për lirim nga TVSH për shumën prej 112,209€.

<sup>1</sup> Në këtë vlerë është e përfshirë TVSH

<sup>2</sup> Borgji i UN HABITAT pa e përfshirë TVSH-në